

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departmenti i Kimisë / Fakulteti i FSHMN-së
Titulli i lëndës:	Kimia e përgjithshme
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, sem I
Numri i orëve në javë:	4+3
Vlera në kredi – ECTS:	9
Koha / lokacioni:	-----/ Departamenti i Kimisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc. Musaj Paçarizi, prof. asoc
Detajet kontaktuese:	044 / 229 828 dhe m_paqarizi@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Kimia është shkencë natyrore e cila studion materien, substancat si dhe transformimin e substancave prej një forme në tjetrën. Kimia e përgjithshme paraqet njohurit e përgjithshme të Kimisë: ligjet kimike, format e ndryshme të materies, substancat në gjendje të ndryshme agregate (të ngurtë, të lëngët, të gaztë si dhe gjendjen e plazmës). Kimistët i aplikojnë shumë metoda fizike dhe aparate matematike, ata i përdorin ato për përcaktimin e strukturave kimike dhe studimin e proceseve kimike. Kimia e përgjithshme si lëndë përmban njohurit e shumë disiplinave të Kimisë si: struktura e lëndës-atomet dhe molekulat; lidhjet kimike, sistemin periodik të elementeve-vetitë e elementeve; termodinamika dhe kinetika kimike, elektrokiminë- bazat e reaksioneve oksido-reduktimit.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi i ligjeve themelore të Kimisë. 2. Përdorimi i metodave adekuate për ndarjen e substancave të pastra nga përzierjet. 3. Dhënja e informatave bazë për strukturën e atomit dhe molekulës. 4. Dhënja e informatave të mjaftueshme për zhvillimin e reaksioneve kimike (ndryshimi i nxehtësisë, shpejtësia e zhvillimit të tyre, reaksionet e oksido-reduktimit, etj).
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Studenti do të dijë t'i dalloj të kuptoj dhe interpretoj ligjet themelore të kimisë. 2. Të shpjegoj proceset e ndryshme kimike; energjia e jonizimit, elektronegativiteti, formimin dhe shkëputjen e lidhjeve kimike. 3. Studenti do të dijë t'i dalloj lidhjet kimike jonike, kovalente, metalike dhe ato intermolekulare. 4. Studenti do të njoh parimet bazë të elektrokimisë, ligjet e Faradejit, do të dij të shkruaj si dhe të

	barazoj reaksionet e oksido-reduktimit. 5. Studenti do të jetë në gjendje të shjegoj nocionet bazë të kinetikës kimike. Do të dijë të masë eksperimentalisht dhe të llogaris shpejtësinë e një reaksioni të thjeshtë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	4	12
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	8	7	56
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	3	9
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			252
Metodologjia e mësimdhënies:	Punë praktike, Ligjërata, Diskutime (Bashkëbisedë), Seminare (Detyra)		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi në praktikë dhe në teori: Vlerësimi i parë: 20 % Vlerësimi i dytë 20 % Punimi seminarik 10 % Ushtrimet 20 % Provimi final 30 % Totali 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. I. Filipovic; S. Lipanovic; Kimia e përgjithshme, (përkthim nga Xh. Ahmeti) Prishtinë, 1996. 2. R.Chang: General Chemistry ; 10th edition, New York, USA, 2010		
Literatura shtesë:	1. R.Petruci, F.Herring, J.Maduro, C.Bissonnette: General Chemistry-Principles and Modern Application, 10 th edition, USA, 2011. 2. J. Mc.Murry and R. Fay, Chemistry ,4 th edition, New Jersey, USA, 2004.		

	<ol style="list-style-type: none"> 3. M. Silberberg; Chemistry; 4th edition, New York, USA, 2006 4. M. Sikirica; Stekiometria; Prishtinë: 1997. 5. Studentët mund të shfrytëzojnë edhe ndonjë tekst tjetër në gjuhë të huaja, apo edhe material nga interneti.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Shkencat natyrore dhe kimia. Substancat e pastërta dhe perzierjet.
<i>Java e dytë:</i>	Ligjet e bashkimit kimik sipas masës dhe sipas vëllimit. Gjendja e gaztë e materies.
<i>Java e tretë:</i>	Masa atomike dhe masa molekulare relative, moli, reaksionet kimike dhe ekuacionet e tyre.
<i>Java e katërt:</i>	Struktura e atomit-Grimcat elementare, rrezet rentgen dhe radioaktiviteti. Izotopet dhe struktura e bërthamës së atomit.
<i>Java e pestë:</i>	Struktura elektronike e atomit-Modeli i Bohr-it, spektrat atomik dhe struktura atomike, numrat kuantik. Sistemi periodik i elementeve.
<i>Java e gjashtë:</i>	Lidhjet kimike-Lidhja jonike dhe lidhja kovalente
<i>Java e shtatë:</i>	Struktura gjeometrike e molekulës dhe polarizimi i lidhjeve kimike. Forcat ndërmolekulare dhe lidhja metalike.
<i>Java e tetë:</i>	Tretësirat dhe vetitë e tyre. Tretësirat e elektrolitëve.
<i>Java e nëntë:</i>	Vlerësimi i parë intermediar. Ndryshimet energjetike gjatë reaksioneve kimike-Termokimia, energjia e lirë e reaksionit kimik.
<i>Java e dhjetë:</i>	Kinetika kimike, ndikimi i faktorëve të ndryshëm në shpejtësi të reaksioneve kimike. Ekuilibri kimik i sistemeve homogjene dhe heterogjene.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Baraspeshat në tretësirat e elektrolitëve. Acidet dhe bazat , tretësirat puferike, asnjësimi i acideve me baza, hidroliza e kripërave, produkti i tretshmërisë.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Llojet e reaksioneve kimike. Oksidimi dhe reduktimi. Barazimi i reaksioneve redoks.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Elektrokimia-Elementet galvanike, potencialet redokse, ekuilibrat redoks, elektroliza.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Emërtimet e komponimeve inorganike. Komponimet komplekse.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kimia bërthamore-Reaksionet bërthamore natyrore dhe artificiale Vlerësimi i dytë intermediar.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijimi i rregullt i studentëve në ligjëratat është i dëshirueshëm kurse në ushtrime është i obligueshëm. Ardhja me kohë në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve shkyqja e telefonave është e domosdoshme.